



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery	26-07-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHIK	979/2023		1/6



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.1066/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1066/2022 të datës 29.11.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 26.01.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1066/2022 e datës 29.11.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi KA.nr.38/2022 i datës 11.11.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Kontrata e Punës (*për kohë të caktuar*) Nr.01/1094 e datës 29.07.2022, ndërsa, mbetet në fuqi Akt Emërimi Nr.03/167 i datës 02.04.2014 për pozitën e punës Administrator në Gjykatën Themelore në Gjakovë, për ankuesin si në pikën I të këtij vendimi.
- III. Obligohet Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

## A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën e punës Administrator në Gjykatën Themelore në Gjakovë – Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datën 29.11.2022 ka parashtruar ankesën me numër protokoll 7468/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.1066/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.38/2022 të datës 11.11.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (*tani e tutje referuar si SKGJK*), për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave ligjore dhe aplikimit të gabuar të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 05.12.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datën 22.12.2022 ka përcjellë provat e lëndës, por jo edhe përgjigjen me shkrim lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.01.2022 me Vendimin me numër protokoll 182/2023 ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1066/2022 të datës 29.11.2022, të parashtruar nga ankuesi

Kolegji i Këshillit, pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritori administroi këto prova: Ankesën me numër protokoll 7468/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.1066/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit me numër Nr.03/167 të datës 07.04.2014 të ankuesit; Kontratën e Punës për kohë të caktuar të datës 06.06.2007; Kontratën e punës për kohë të caktuar të ankuesit me numër Nr.01/1094 të datës 29.07.2022; Vendimin me numër KA.nr.38/2022 të datës 11.11.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.12.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 22.12.2022 nga SKGJ; Njoftimin me numër Nr.01/2074 të datës 11.11.2022 nga SKGJK lidhur me zbatimin e vendimit A.nr.776/2022 të datës 20.10.2022 të Këshillit; Flet kthesat nga Posta e Kosovës; Ankesën e ankuesit me numër Nr.01/1571 të datës 10.08.2022 të parashtruar të KZKA si dhe Vendimin me numër protokoll 182/2023 të datës 11.01.2023 lidhur me vazhdimin e afatit për vendimmarrje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi Rudin Elezi, më datë 07.04.2014 kishte nënshkruar Aktin e Emërimit Nr.03/167, me të cilin kishte themeluar marrëdhënie të përhershme të punës, si nëpunës civil i karrierës, në pozitën e Administratorit të Gjykatës Themelore në Gjakovë.

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, mbi bazën e dispozitave të Rregullores Nr.04/2022 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimit të Marrëdhënies së Punës për Administrator të Gjykatave, më datën 29.07.2022, ankuesit i kishte ofruar për nënshkrim Kontratën e Punës për kohë të caktuar - pesë (5) vjeçare për pozitën e njëjtë të punës si Administrator i Gjykatës Themelore në Gjakovë.

I pakënaqur me vendimin e organit të punësimit lidhur me zëvendësimin e aktit të emërimit të përhershëm, me kontratë të punës me kohë të caktuar, ankuesi me datën 10.08.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së, ndërsa kjo e fundit me datën 29.08.2022 me Vendimin KA.nr.28/2022 ka shpallur veten jo kompetent për të vendosur, me arsyetimin se ankuesi nga nënshkrimi i kontratës së punës për kohë të caktuar, me datë 29.07.2022, nuk e gëzon statusin e nëpunësit civil, dhe se marrëdhënia e tij e punës rregullohet me dispozitat e Ligjit të Punës.

Kundër Vendimit KA.nr.28/2022 të datës 29.08.2022, ankuesi me datën 25.08.2022 dhe 07.09.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa kjo e fundit me Vendimin me numër A.nr.776/2022 të datës 20.10.2022 ka aprovuar si të bazuar ankesën e datës 25.08.2022, dhe si rrjedhojë ka shfuqizuar Vendimin me numër KA.nr.28/2022 të datës 29.08.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë me arsyetimin se shqyrtimi i ankesës të datës 10.08.2022 të parashtruar nga ankuesi Rudin Elezi është në kompetencë të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në SKGJK, duke u mbështetur kështu në dispozitat e nenit 81 paragrafi 1 dhe 2 ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 6 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në SKGJK, në ri procedurë ka trajtuar ankesën e datës 10.08.2022 të ankuesit dhe si rrjedhojë me datën 11.11.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër KA.nr.38/2022, me ç' rast ankesën e datës 10.08.2022 e ka hedhur poshtë si të palejuar, me arsyetimin se nuk ka objekt shqyrtimi lëndor pasi që ankuesi nuk e ka atakuar kontratën në fjalë por një akt tjetër nga marrëdhënia e punës i cili ka ekzistuar para se ankuesi të themelonte marrëdhënie të punës në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Kundër Vendimit KA.nr.38/2022 të datës 11.11.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ankuesi përsëri me datën 29.11.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave ligjore dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, me pretendimin ankimor se zëvendësimi i aktit të emërimit të përhershëm, me kontratë të punës me kohë të caktuar, gjegjësisht ndryshimi i statusit të marrëdhënies së punës nga statusi i nëpunësit civil të karrierës me afat të përhershëm në statusin e të punësuarit me kontratë pune me afat të caktuar dhe që i nënshtrohet dispozitave të Ligjit të Punës, është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi që marrëdhënia e punës e stafit të gjykatave i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji dhe si e tillë është e karrierës - pa afat të caktuar.

Kolegji i Këshillit në kuptim të përcaktimit të statusit të marrëdhënies së punës të stafit administrativ në sistemin gjyqësor dhe aplikimit të ligjit material, analizoi Aktgjykimin në rastin KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin është konstatuar se neni 2 paragrafi 3 (fusha e zbatimit) dhe neni 85 i Ligjit Nr.06/114 për Zyrtarët Publikë, nuk janë në pajtueshmëri me nenin 108 (Këshilli Gjyqësor i Kosovës) të Kushtetutës, dhe si rrjedhojë duke ju referuar konstatimeve të dhëna në këtë aktgjykim, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundim së në kuptim të fushës së zbatimit gjegjësisht përkufizimit të shërbimit civil në sistemin gjyqësor ka mbetur në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil i Republikës së Kosovës.

Me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 3 paragrafi 6 përcaktohet se: *6. Personeli administrativ i punësuar në sistemin gjyqësor dhe prokurorial është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi, me përjashtim të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nga rrjedhë se personeli administrativ i punësuar në sistemin gjyqësor, duke përfshi këtu edhe Administratoret e Gjykatave janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës, dhe për pasojë, marrëdhënia e tyre e punës i nënshtrohet dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës dhe legjislacionit përkatës, në këtë rast, Ligjit për Gjykata dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.*

Me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 është përcaktuar se në Shërbimin Civil të Kosovës ekzistojnë dy kategori të punësuarve: *1.1. pozitat e nëpunësve civilë të karrierës - të cilët ushtrojnë funksionet në baza të përhershme për arritjen e objektivave të përgjithshme institucionale; dhe 1.2. pozitat e nëpunësve civilë të jo karrierës - të cilët ushtrojnë funksionet me kohëzgjatje të kufizuar deri në dy (2) vjet, për zbatimin e projekteve të caktuara, zëvendësimi i përkohshëm i nëpunësve të përhershëm civilë dhe në raste të mbingarkesave në punë, ndërsa me nenin 19 paragrafi 2 të këtij ligji përcaktohet se: 2. Nëpunësit civilë në pozitat e karrierës pranohen në punë pa afat.*

Rrjedhimisht, me nenin 29 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat, përcaktohet se: *1. Administratori i gjykatës zgjidhet dhe shkarkohet në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës, në një proces të hapur dhe konkurrues, pas shpalljes publike të pozitës, ndërsa me nenin 38 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, përcaktohet se: 1. Këshilli në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil realizon procedurat e rekrutimit dhe të mbikëqyrjes së Administratorëve të gjykatave.*

Kolegji i Këshillit nga analizimi i këtyre dispozitave ligjore konstaton se Administratorët e Gjykatave kanë statusin e nëpunësit civil të karrierës dhe për pasojë marrëdhënia e tyre e punës është e përhershme, ndërsa, themelimi, ndryshimi dhe përfundimi i marrëdhënies së tyre të punës duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil. Rrjedhimisht, për aq kohë sa këto dispozita ligjore janë në fuqi, Kolegji i Këshillit, në dritën e parimit të supremacisë juridike të ligjit, vlereson se me akt nënligjor, përjashtimisht përcaktimit të detyrave dhe përgjegjësiive, nuk mund të përcaktohet ndryshe statusi, akti i themelimit të marrëdhënies së punës, procedura e përzgjedhjes dhe shkarkimi i Administratorëve të Gjykatave, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me shkeljen e ligjit material me rastin e zëvendësimit të akt emërimit të përhershëm, si nëpunës civil i

karrierës, me kontratë të punës për kohë të caktuar-pesë (5) vjeçare, është i drejtë dhe ligjërish i bazuar, ngase veprimi i organit të punësimit për zëvendësimin e Akt Emërimit Nr.03/167 të datës 02.04.2014 më Kontratë të Punës (për kohë të caktuar) Nr.01/1094 të datës 29.07.2022, për arsyet e dhëna si me lartë, është në kundërshtim me dispozitat e nenit 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenit 19 paragrafi 2 ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 6 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 29 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat, nenin 38 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe rrjedhimisht në kundërshtim me parimin e ligjshmeris të percaktuar me nenin 4 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Keshtu që duke u bazuar në dispozitat e nenit 50 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 1. *Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës.* 2. *Nëpunësit civilë kanë të drejtë mbrojtjeje përmes procedurave të brendshme administrative ose gjyqësore në rast të shkeljes së të drejtave të tyre, që rezulton nga një veprim i administratës publike,* Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i SKGJK-së nuk ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar ligjin material me rastin e hedhjes poshtë si të palejuar të ankesës së ankuesit, ngase ashtu siç është vërtetuar me provat e administruara të lëndës, ankuesi nga data 02.04.2014 më Akt Emërimin Nr.03/167, kishte themeluar marrëdhënie të përhershme të punës, si nëpunës civil i karrierës, në pozitën e Administratorit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, ndërsa me datë 29.07.2022, organi përkatës i punësimit për pozitën e njëjtë të punës ankuesit i ofron për nënshkrim Kontratën e Punës Nr.01/1094, për kohe të caktuar - pesë (5) vjeçare. Kolegji i Këshillit thekson faktin se me veprimin e organit të punësimit për zëvendësimin e aktit të emërimit të përhershëm, me kontratë të punës me kohë të caktuar, duke ndryshuar kështu statusin dhe duke përcaktuar se i njëjti i nënshtrohet dispozitave të Ligjit të Punës, ankuesit i janë cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtat nga marrëdhënia e tij e punës, dhe se të njëjtit në momentin e zëvendësimit të aktit të emërimit me kontratë pune me afat të caktuar i ka lindur e drejta për ushtrimin e mjeteve juridike, për çka ankuesi edhe përkundër faktit se kishte nënshkruar kontratën e punës, më datë 10.08.2022 kishte parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, brenda afatit prej 30 dite, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me rastin e vendosjes për hedhje poshtë si të palejuar të ankesës së ankuesit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 50 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ngase me këto dispozita ligjore nëpunësit civilë i garantohet e drejta e mbrojtjeje përmes procedurave të brendshme administrative në rast të shkeljes së të drejtave të tyre, që rezulton nga një veprim i administratës publike, si dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 ndërlidhur me nenin 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse ankuesi në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit kishte legjitimitet për arsye se deri në atë moment mbante statusin e nëpunësit civil dhe me rastin e zëvendësimit të aktit të emërimit të


përhershëm, me kontratë pune me afat të caktuar, për shkak të cenimit të drejtave të garantuara me Ligjin për Shërbimin Civil, parashtrohet ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, organ ky kompetent për shqyrtimin e ankesave të nëpunësve civil sipas nenit 81 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe neni 82 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj Kolegji i Këshillit konstaton se akti i kontestuar, gjegjësisht Vendimi KA.nr.38/2022 i datës 11.11.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKGJK-së, për arsyt e dhena si më lartë është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, persa me siper dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 53 paragrafi 1 dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, shfuqizimin e Vendimit KA.nr.38/2022 të datës 11.11.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Kontratën e Punës (për kohë të caktuar) Nr.01/1094 të datës 29.07.2022, duke lenë në fuqi Akt Emërimin Nr.03/167 të datës 02.04.2014 të ankuesit, për pozitën e punës Administrator në Gjykatën Themelore në Gjakovë.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1066/2022.

Ardita Perçuku-Shyti  
  
Procesmbajtëse



### Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit;
- Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.